



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 42 Prot.

Tiranë, më 19/01/2012

**Lënda:** Rekomandim për “Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë”.

**REKOMANDIM**

Nr. 04, datë 19/01/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

**KONSTATOVA**

Më datë 21/12/2011, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- 1. Veprimet administrative të Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, në lidhje me përgjigjen e dhënë dhe dokumentacionin shoqërues, në vijim të kërkesës Nr.217/7, datë 21.07.2011, të përfaqësuesit ligjor të z.Gjergji Bicolli.**
  - Verifikimi i përhapjes të të gjitha të dhënave, Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010, bazuar në nenet 5, 6, dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me:
  - Qëllimin e përpunimit të të gjitha të dhënave, Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010;
  - Verifikimi i subjekteve, ku janë përhapur këto të dhëna, përkundrejt qëllimit;
  - Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave;

- Saktësinë dhe qartësinë në përpunimin e të dhënave;
- Verifikimi i kategorive të subjekteve që ju përpunohen të dhënat, përkundrejt qëllimit;
- 2. Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, kategorive që ju përpunohen të dhënat, Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010, bazuar në nenet 12, 13, 15, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me:
- Informimin e subjekteve që i nënshtrohen këtij përpunimi, nëpërmjet përhapjes tek të tretët;
- Nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti/tet e të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e këtyre të dhënave, nëse është kërkuar korrigjimi ose fshirja e këtyre të dhënave, si dhe, nëse subjektet e këtyre të dhënave kanë kundërshtuar përpunimin nëpërmjet përhapjes tek të tretët.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë nuk ka respektuar nenin 5, paragrafi 1, germa ”c”, sipas të cilit:

*“1-Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:*

*c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim.”*

Nga ana e kontrolluesit, me vënien në dispozicion Av. Luan Merlika, person i tretë, të Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010, kur duhej t’i siguronin atij vetëm të dhënat për klientin-ish punonjës të Shoqërisë “ROFIX”Sh.p.k., bazuar kjo në Nenin 6 të ligjit Nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për avokatinë”, ka tejkaluar qëllimin e përpunimit dhe kjo përhapje tek të tretët është jo proporcionale, pasi kanë dhënë më shumë të dhëna se sa ligji lejon, për pasojë është shkelur neni 5/1/c i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Për sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

#### **REKOMANDOJ**

1. Njohjen me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe trajnimin e stafit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, rreth mbrojtjes

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

